

VENDIM
Nr. 1083, datë 28.12.2015

**PËR SHPËRBLIMIN DHE KOMPENSIMIN E DISA KATEGORIVE TË VEÇANTA
PËR FESTAT E FUNDVITIT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, dhe të neneve 10 e 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në sistemin e arsimit publik jepen shpërblime për kategoritë e mëposhtme:
 - a) Për 500 mësuesit më të spikatur jepet shpërblimi, në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë.
 - b) Për nxënësit e shkëlqyer në ciklin e dytë të sistemit e arsimit 9-vjeçar dhe të mesëm jepet shpërblimi prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.
 - c) Për studentët e ekselencës në sistemin e arsimit të lartë jepet shpërblimi prej 5 000 (pesë mijë) lekësh.
Efektet financiare përballohen nga buxheti i Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, miratuar për vitin 2015.
2. Për 300 mjekët më të spikatur jepet shpërblimi, në masën 40 000 (dyzet mijë) lekë. Efekti financiar përballohet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor, miratuar për vitin 2015.
3. Përfituesit nga skema e ndihmës ekonomike dhe paaftësisë përfitojnë kompensimin financiar në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) Familje të cilat trajtohen me ndihmë ekonomike;
 - b) Familje që kanë në përbërjen e tyre anëtarë me aftësi të kufizuara, të lindur ose të bërë të tillë, të cilët deklarohen të paaftë për punë me vendim të KMCAP-së, sipas pikës 3, të nenit 7, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”;
 - c) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8626, datë 22.6.2000, “Statusi i invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik”, të ndryshuar;
 - ç) Individët përfitues të statusit sipas ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996, “Për statusin e të verbrit”, të ndryshuar.
Efektet financiare përballohen nga zëri “Ndihma ekonomike dhe pagesa e paaftësisë”, miratuar në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për vitin 2015.
4. Pensionistët përfitojnë kompensimin financiar, në masën 2 000 (dy mijë) lekë, të ndarë sipas kategorive të mëposhtme:
 - a) Personat, që marrin pension pleqërie, pension invaliditeti, pension familjar dhe pension social, sipas ligjeve nr. 4171, datë 13.9.1966, “Për sigurimet shoqërore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 - b) Personat, që marrin pension, sipas ligjit nr. 4976, datë 29.6.1972, “Për pensionet e anëtarëve të kooperativave bujqësore në Republikën Popullore të Shqipërisë”, dhe sipas paragrafit të katërt, të nenit 96, të ligjit nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.
 - c) Personat, që marrin trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 8685, datë 22.6.2000, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në miniera, në nëntokë”, të ndryshuar, dhe personat, që përfitojnë trajtim të veçantë financiar, sipas ligjit nr. 9179, datë 29.1.2004, “Për një trajtim të veçantë të punonjësve, që kanë punuar në disa ndërmarrje të industrisë ushtarake”, të ndryshuar.
 - ç) Personat, që marrin pension të parakohshëm për vjetërsi shërbimi, sipas ligjit nr. 10142, datë 15.5.2009, “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakeve të Forcave të Armatosura, të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të

Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe personat që marrin pension sipas ligjit nr. 150/2014, “Për pensionet e punonjësve që kanë punuar në miniera në nëntokë”.

Efektet financiare përballohen nga buxheti i miratuar për vitin 2015 për skemën e sigurimeve shoqërore në buxhetin e Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe ministrinë e institucionet e përmendura në këtë vendim për detajimin e fondeve sipas strukturës përkatëse buxhetore dhe përcaktimin e procedurës së dhënies së shpërblimeve dhe të kompensimit financiar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Edi Rama